



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.901/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses DIAN-ING IPE sh.p.k., export import me NB 6828779 dhe me nr. tatimor 4043012512290, me pronar D.N. me adresë në Trifun Haxhijenev nr. 1-1/5 Shkup-Republika e Maqedonisë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim A.A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, “DITI-AS” sh.p.k, me nr. të biznesit 600923024 me pronar J.K. dhe I.K., me adresë në lagjen “Jeta e Re” p.n.-Komuna e Lipjanit, objekt i kontestit: mos përmbushje të kontratës-pagesa e borxhit , duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti Ekonomik, IV.EK nr.152/19 të datës 20.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurit DITI-AS” sh.p.k, me nr. të biznesit 600923024 me pronar J.K. dhe I.K., me adresë në lagjen “Jeta e Re” p.n.-Komuna e Lipjanit.

II. PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti Ekonomik, nr. IV.EK nr.152/19 të datës 20.01.2022, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale, dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik, IV.EK nr.152/19 të datës 20.01.2022, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “DIAN-ING IPE” sh.p.k, export - import me nr. të biznesit 6828779 dhe me nr. tatimor 4043012512290, me pronar D.N. me adresë në Trifun Haxhijenev nr. 1-1/5 Shkup-Republika e Maqedonisë. Ne pikën II te dispozitivit Detyrohet i padituri “DITI-AS” sh.p.k, me nr. të biznesit 600923024 me pronar J.K. dhe I.K., që në emër të mos pagesës së borxhit, paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 38,375.00 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit e cila fillon te rrjedh nga data e paraqitjes së padisë dt. 25.03.2019, e deri në pagesën definitive,në afatin kohor prej 7 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurit, për shkak shkelje te dispozitave te procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim te gabuar te se drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu qe te beje refuzimin e kërkesëpadisë si te pabazuar apo aktgjykimi te prishe dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e **bazuar**.

Paditësja “DIAN-ING IPE” sh.p.k, export - import me nr. të biznesit 6828779 dhe me nr. tatimor 4043012512290, me pronar D.N. me adresë në Trifun Haxhijenev nr. 1-1/5 Shkup-Republika e Maqedonisë, përmes përfaqësuesit të autorizuar në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datën 25.03.2019 kundër të paditurës “DITI-AS” sh.p.k, me nr. të biznesit 600923024 , për mos pagesë të borxhit në bazë të kontratës, me kamatë ligjore prej 8%, njuhërit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore por të njëjtat nuk i ka specifikuar. Tutje paditësit ka theksuar se me palën e paditur kanë qenë në raport kontraktues nga kontrata me numër 03-2015-20/D e datës 26.05.2015 dhe aneksit mbi kushtet e veçanta . paditësi pas nënshkrimit të kontratës me të paditurin i ka ofruar te gjitha pajisjet palës se paditur duke përfshirë makineritë për përpunimin e qumështit e të cilat janë me të specifikuar në bazë të listës specifike te bashkangjitura kësaj padie, i padituri ka filluar të kryej pagesat ndaj palës se paditur fillimisht me dt. 14.09.2015, është paguar fatura në tërësi me 65/15 në vlerë 46,600.00 euro, ndërsa fatura e dytë është paguar me dt 30.11.2015, me nr. fatura 75/15 në vlerë prej 37,750 .00 euro me dt 08.06.2016, ka paguar shumën prej 5,000.00 euro, me dt 14.09.2016, ka paguar shumën prej 4,900.75 euro ndërsa ka mbetur borxh shumën prej 38,375. 00 euro prej vlerës total që ka qenë 130,700 euro e cila ka qenë e nënshkruar në mes të palëve ndërgjyqësve. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet ne tërësi padia e paditësit Shoqëri për prodhim, shërbime dhe inxhiniering Dian-IN IPE shpk eksport-import me nr. të biznesit 6828779 dhe me nr. tatimor 4043012512290, me pronar D.N. me adresë, Trifun Haxhijanev me nr. 1-1/5-Shkup-Republika e Maqedonisë, ashtu që të detyrohet i padituri Diti-As Shpk-Lipjan me nr e biznesit 600923024, me pronar J.K. dhe I.K. me adresë ne Lagjen Jeta e Re, pn. Komuna e Lipjanit që të i’ a paguaj paditësit borxhin kryesor shumën e parave në vlerë prej 38,375.00 euro me kamat prej 8%, duke llogaritur nga data 14.09.2016 prej pagesës se fundit me kanosje të përmbarimit të mundshëm , gjithashtu obligohet e paditur qe paditësit ti paguaj shpenzimet procedurale te krijuara në angazhimin e avokatit.

Pala e paditur e ka kontestuar kërkesëpadinë, ndër të tjera ka theksuar se nuk është kontestuese se me palën paditëse kanë qenë në raport kontraktues nga kontrata, mirëpo e pala paditëse ka qenë e obliguar që makineritë ti montoj dhe ti funksionalizoj e pastaj të bëhet pranimi teknik i tyre dhe me këtë rast do të realizohet kontrata nga ana e palës paditëse, prandaj mosrealizimi i kontratës rrjedh nga pala paditëse. Ka shtuar se makineritë të cilat i ka sjellë pala paditëse nuk janë montuar

për arsye të njëjta nuk i përgjigjen standardeve dhe kanë të meta të mëdha dhe nuk kanë mundur asnjëherë të vihen në funksion, prandaj me këtë rast pala paditëse i ka shkaktuar dëm të madh palës së paditur në fitimin e humbur. Pala e paditur ka shtruar edhe çështjen e parashkrimit duke cekur se kanë kaluar më tepër se tre vite nga momenti i arritjes për pagesë deri tek kërkesa e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e, me të cilin e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Gjykata tutje ka arsyetuar se nuk ishte kontestuese se pala paditëse me palën e paditur, kishin lidhur kontratën me nr. identifikimi 03-2015-20/D e dt. 26.05.2015 dhe aneksi mbi kushtet e veçanta për furnizim me makineri të përpunimit të qumështit për të paditurin. Pas nënshkrimit të kontratës nuk ishte kontestuese se e paditura kishte pranuar të gjitha makineritë për përpunimin e produkteve të qumështit në bazë të kontratës. Në bazë të faturës së datës 31.08.2015 me nr. 65/15 në vlerë prej 46.600.00 euro për pasterizuesin gjykata vërtetoi faktin se kjo faturë është paguar në tërësi nga e paditura me datë 14.09.2015. Në bazë të faturës së datës 30.10.2015 me nr. 75/15 në vlerë prej 37.750.00 euro për Cip prodhimin gjykata vërtetoi faktin se kjo faturë është paguar në tërësi nga e paditura me datë 30.11.2015. Ndërsa me datën 23.03.2016 është dërguar fatura e fundit me nr.19/16 në vlerë prej 48.350.00 euro ku gjykata vërtetoi faktin se e paditura me datën 08.06.2016 ka paguar shumën prej 5,000.00 euro dhe me datën 14.09.2016 ka paguar edhe një faturë tjetër në shumën prej 4,975.00 euro, ndërsa shuma prej 38,375.00 euro nuk ishte paguar paditësit. Kontestuese në këtë çështje juridike ishte mos pagesa e borxhit prej 38,375.00 euro ashtu siç pretendon pala paditëse.

Gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur lidhur me atë se pala paditëse ka qenë e obliguar që makineritë ti montoj dhe ti funksionalizoj e pastaj të bëhet pranimi teknik i tyre dhe me këtë rast do të realizohej kontrata nga ana e palës paditëse, si dhe pretendimin se makineritë të cilat i ka sjellë pala paditëse nuk janë montuar për arsye të njëjta nuk i përgjigjen standardeve dhe kanë të meta të mëdha dhe nuk kanë mundur asnjëherë të vihen në funksion, por pretendimet e tilla i refuzoj si të pa bazuara sipas arsyesimit të këtij aktgjykimi, pasi që neni 32 i aneks kontratës përcakton se kontraktuesi duhet të garantojë se furnizimet janë të reja të papërdorura, të modeleve më të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e fundit në dizajn dhe materiale si dhe kontraktuesi të garantojë më tej që asnjë nga furnizimet të mos ketë defekte që dalin si rezultat i dizajnit, materialeve ose mjeshhtërisë ku kjo garanci do të mbetet e vlefshme për një vit pas pranimit të përkohshëm, andaj gjykata duke u bazuar në këtë kusht të kontratës pasi që kishte kaluar një vit nga lidhja e kontratës si dhe duke u bazuar në nenin 173 par.1 të LMD-së e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit në tërësi të bazuar.

Gjykata vendimi e ka bazuar ne nenin nenit 8.1, 136,137 si dhe 387 të LMD-se, lidhur me kumatën ne baze të nenit 382.2 të LMD-së, ndërsa shpenzimet e 463 te LPK-së për. Andaj me aktgjykimin e atakuar është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*. Kolegji, i Dhomave të Shkallës së Dytë, shqyrtoi me kujdes shkresat e lëndës, dhe erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka nxjerr duke mos e zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën ligjore nga neni 183 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare..*

Kolegji konstaton se duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë aktgjykimit të ankimuar, për arsye se, aktgjykimi i goditur është i mangët dhe nuk përmban te gjitha elementet dhe pikat e vlerësimit për secilën pretendim të palëve ndergjyqese, për një vendim të arsyetuar, sepse nuk i janë adresuar argumentet thelbësore, me rastin e vlerësimit, për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për të gjitha pretendimet e ngritura nga paditura. Kolegji vlerëson se një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga gjykata e shkallës së dytë, si dhe duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të këtë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë dhe t'u dëshmojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe t'u ofrojë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Rrjedhimisht, aktgjykimi i atakuar nuk është në përputhje me standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, siç janë të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-se dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-se.

Në lidhje me pretendimet ankimore të palës së paditur, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në arsyetim të aktgjykimit është dashur ti jep të gjitha vlerësimet e saj, në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura nga palët ndergjyqëse. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike pasi që pas dhënies se detyrave për plotësim ekspertize nuk është vetëtuar plotësisht gjendja faktike nga eksperti makinerisë, i cili ka deklaruar se *“nuk ka përfunduar plotësim ekspertizën”*. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar drejte gjendjen faktike pasi edhe përkundër caktimit të ekspertizës nuk ka përfunduar pune ekspertet sipas detyrave të dhëna me aktvendimin për plotësimin ekspertizës. Kolegji e konsideron të bazuara pretendimet e të paditurës të parashtruara në ankese se në arsyetimin e aktgjykimin e ankimuar nuk janë dhënë sqarime lidhur me mosdhënien e besimit dhe mos marrjen parasysh të konstatimeve të bëra në ekspertizën e makinerisë. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar ka pasur për obligim që në arsyetim të aktgjykimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të paditurës. Në këtë drejtim,

grykata e shkallës së parë ka dështuar të jep sqarime të nevojshme në arsyetim të aktgrykimit në lidhje me pretendimet e palës paditure pasi ne mënyre selektive ka shqyrtuar pretendimet e palës paditure. Në rastin konkret grykata e shkallës së parë ka aprovuar si te bazuar padinë e paditësit, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht pa vërtetuar me prova faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktgrykimi i atakuar nuk është e qarte se si grykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi kur ka aprovuar padinë.

Në lidhje me pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, kolegji vlerëson se grykata e shkallës së parë me rastin rastin e hartimit të aktgrykimit është dashur të zbatojë në tërësi nenin 160 të LPK-së, përkatësisht në zbatim të parag. 4 dhe 5 të nenin të cekur më lartë, grykata e shkallës së parë ka pasur për obligim që në arsyetim të aktvendimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë prezantuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato, përfshirë këtu dhënien e arsyetimit edhe për të gjitha çështjet tjera të ngritura nga palët ndërgjyqëse gjatë procedurës, si dhe cilat norma të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditësit. Qëndrimin juridik të grykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë, për shkakun se kjo grykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkeljet thelbësor te dispozitave ligjor edhe vërtetimi jo te plot te gjendjes faktike dhe si rezultat i kësaj tani për tani edhe me zbatim te gabuar te drejtës materiale për të cilën grykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 194 të LPK. Mos vërtetimi i vlefshmërisë së provave kontestuese, si prova të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejte në nxjerrjen e aktgrykimit të ligjshëm dhe të drejtë, përbejnë shkelje të dispozitës së Nenit 183.1 të LPK-së, i cili përcakton se ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur grykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.

Duke u nisur nga kjo gjende e tillë e çështjes kolegji i kësaj grykate ka gjetur se nuk mund të pranohet konkludim juridik i grykatës së shkallës së parë, si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kësaj grykate, për shkak të mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale, prandaj është dashur që aktgrykimi i goditur të priset dhe lënda ti kthehet grykatës së shkallës së parë në rigrykim.

Bazuar në të lartëcekurat, rezulton se grykata e shkallës së parë aktgrykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, grykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret grykata e shkallës së parë ka marrë vendimin e atakuar, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes. Nga shkresat e lëndës rezulton fakti i pakontestueshëm se në procedurë të shkallës së parë, nga ana e grykatës është angazhuar eksperti i makinerisë gjyqësor i cili nuk ka sqaruar në menynë të plot çështjen kontestuese sipas detyrave te grykatës, gjegjësisht faktet që duhet vërtetohen nga eksperti, kanë mbet të pavërtetuara, për çka gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë. Kolegji vlerëson se një ekspertize e tille

është jo e plotë, pa sqarimet e nevojshme, çka të njëjta nuk e ka arritur qëllimin për të cilin është nxjerrë, dhe nuk i përmban as të dhëna të cilat janë kërkuar, ekspertiza duhet të jetë e plotë dhe të përmbajë të gjitha të dhënat në mënyrë që gjykata të mund të vendos lidhur me kërkesën, po ashtu gjykata të marrë parasysh pretendimet e palëve gjatë procedurës, provat në shkresat e lëndës, të vlerësohen një nga një dhe të ndërlydhura në mes vete, ashtu që të krijohen kushtet që gjykata të vendos lidhur me kërkesëpadinë, duke marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar, doemos është dashur të priset.

Në ri procedurë Dhomat e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga Kolegji i kësaj gjykate, të shqyrtoj me kujdes dispozitat, si dhe provat që janë nxjerr gjatë procedurës , ashtu që me rastin e vendim marrjes. Dhomat e shkallës së parë udhëzohet qe ne ri procedure te caktoj një ekspert tjetër i cili do te përfundoj ekspertizën nga lemia përkatës, për të vërtetuar saktë gjendjen faktike.

Nga te cekurat me lart, e në mbështetje të nenit 195 parag. 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.901/22, me datë 08.02.2024.

**Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi**